



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC**

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË  
EKZEKUTIVE**

**Pogradec më 18 / 04 / 2017**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore pranë Bashkisë Pogradec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

- a. 1 (Një) pozicion – Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimin e territorit, Drejtoria e kontrollit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit.**
- b. 1 (Një) pozicion – Specialist për inspektimin e zhvillimit kadastrën urbane dhe sistemin GIS, Drejtoria e kontrollit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit.**

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë vakante, atëherë janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin nga jashtë shërbimit civil. Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele dhe pranim nga jashtë shërbimit civil) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: 28 Prill 2017

Afati për dorëzimin e dokumentave për pranim në SHËRBIMIN CIVIL : 4 Maj 2017

Intervista e strukturuar me gojë, për kandidatët që kualifikohen për lëvizjen paralele, do të zhvillohet në datën 02.05.2017, pranë Zyrës së Burimeve Njerezore, të Bashkisë Pogradec.

Ndërsa konkursi me shkrim, për pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të zhvillohet në datën 12.05.2017, pranë ambjenteve të Bashkisë Pogradec.

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin :**

- **Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimin e territorit**

1.Është punonjës në varësi direkte nga drejtoria e kontrollit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

- 2.Hartojnë projekte të ndryshme dhe ia paraqesin eprorit të drejtperdrejtë për konsultim dhe me pas për miratim;
- 3.Plotësimi me detaje teknike të projekteve të dorëzuara me qëllim miratimin përfundimtar të tyre;
- 4.Në bashkëpunim me specialistë të ndryshëm marrin masa për hartimin e planit vendor të zhvillimit;
- 5.Ndjekin procedurat ligjore për hartimin dhe miratimin e PPV dhe PDV;
- 6.Prezantojnë në publik projektet e hartuara si dhe marrin në konsideratë mendimin e tij për miratimin përfundimtar të këtyre projekteve;
- 7.Kryejnë të gjitha detyrat e tjera të dhëna nga Drejtori që kanë të bëjnë me zbatimin praktik të ligjit për planifikimin e territorit.

- **Specialist për inspektimin e zhvillimit kadastrën urbane dhe sistemin GIS**

1. Drejton punën në sektor për detyrat e sektorit në hartimin e instrumentave vendore të planifikimit të territorit (PPV,PDV etj )
2. Mer pjesë në hartimin e politikave vendore të zhvillimit të territorit ,në pasqyrimin e përparësive ,qëllimet strategjike dhe objektivat e njësisë vendore.
3. Drejton punën në sektor për hartimin , Planet e Detajuara Vendore dhe kontrollon ( ne ratet kur PDV hartohen nga subjekte,ente publike ose private ) përputhshmërinë e tyre me PPV instrumentat e zhvillimit te territorit bazuar ne ligjin “Për Planifikimin e Territorit”, duke u mbështetur ne dokumentacionin topografik nga Kadastra Urbane dhe specialisti i GIS mbi hartat dhe kufijtë administrative të njësisë vendore te paraqitura ne sistemin e gjeoreferimit te përcaktuara ne VKM nr.459 date 23 /06 /2010’’ Per miratimin e standardeve te perbashketa gjeodezike dhe GIS te regjistrir te territorit’’
4. Përgatit material për dergimin e PDV – ve se bashku me relacionin shpjegues ne mbështetje te nenit 57 të “Rregullores se Planifikimit të territorit”
5. Bashkëpunon me dhe Z.V.R.P.P. për konfirmimin e pasurive dhe mban korrespondence të problematikat në këtë aspekt.
6. Në bashkëpunim me specialistin e Kontrollit të lejeve të zhvillimit,ndërtimit dhe infrastrukturës,mban aktet e kontrollit sipas fazave të punimeve konform nenit 27 Vendim Nr. 408, Datë 13.5.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.
7. Të zhvillojë dhe shpërndajë produktet, të dhënat dhe shërbimet të Gis-it, si dhe të administrojë mbledhjen, migrimin, importimin dhe riformatimin e të dhënave, krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave aktuale duke përdorur programe Gis (ArcGis 9.1),të saktësojë programet e nevojshme përmbajtjen e të dhënave dhe përgatitjen e përpunimin e hartave bazuar në programet bashkëkohore të GIS dhe kujdeset per rinovimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

## 1.LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori,në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë;
- b- Preferohet të ketë eksperiencë pune, në fushat përkatëse;

### 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës
- c- Fotokopje e deshmisë së gjuhës së huaj
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

### 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit, në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe pranë Zyrës së Punës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për lëvizjen paralele. Po në të njëjtën datë do të njoftohen nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore kandidatët të cilët nuk kanë plotësuar kushtet dhe kërkesat e posaçme

#### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1.Ligji nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e teritorit".
- 2.Ligji nr 8402, datë 10.9.1998 'Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.
- 3.Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, i ndryshuar;
- 4.VKM nr. 1055 datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”
- 5.Vkm nr 408, datë 13.5.2015" Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.
- 6.Vendim nr .554 , date 18.06.2015 " Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj

#### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJEN PARALELE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët për lëvizjen paralele në këto pozicione pune do të vlerësohet si më poshtë:

- 1) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar ndarë në:
  - 1.1) 20 pikë për përvojën
  - 1.2) 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse
  - 1.3) 10 pikë për çertifikimin pozitiv
- 2) 60 pikë intervista me gojë

#### **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Pogradec do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJMBNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **2. PRANIMI NË SHËRBBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

## **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHERBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të ketë arsim të lartë në fushën përkatëse.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës ;
- c- Fotokopje e dëshmisë së gjuhës së huaj
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në 9 maj 2017 Njësia e Menaxhimit të burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme.

## **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4**

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në stendat e informimit të publikut, në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për rezultatet nëpërmjet (adresës së e-mail). Brenda tre ditëve kalendarike nga njoftimi individët kanë të drejtë të paraqesin ankesa me shkrim pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.